

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Afd është armiku më i keq i Italisë"/ Tajani akuzon partinë gjermane se promovon shkëputjen e Tirolit të Jugut
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/afd-eshte-armiku-me-i-keq-i-italise-tajani-akuzon-partin-e-gjermane-se-promo-i587790
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:45:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 21:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	339f8796c57c3ebc0fac7fa57087d3be5d31830326728193a03ef8110b079d85
TEKSTI	550c12d53dd049099f5f91fcd6dd5bc00f1e5bebc11ca011b39a77b30c18fdbc
PAMJA	e3b68de7bc5b817846dad6b152df3925fd95dd62e905dd81fa45aa7486905f18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cfe551e1185724bb7e8b90e70853046bed162bf60fe1aae30f2d4e09ae1c1b6c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/cfe551e1185724bb7e8b90e70853046bed162bf60fe1aae30f2d4e09ae1c1b6c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Zelensky flet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lufte ne Ukraine](#) C'mimet e banesave t'renojne rritjen, por nuk u len duhen me shum
fundit

“AfD është armiku më i keq i Italisë”/ Tajani akuzon partinë gjermane se promovon shkëputjen e Tirolit të Jugut



22 Shtator 2026, 23:00Bota TEMA



“AfD po promovon dhe mbështet shkëputjen e Tirolit të Jugut nga Italia”, këto ishin fjalët e Ministrit të Jashtëm italian, Antonio Tajani për partinë gjermane të ekstremit të djathtë.

“Po i referohem një ngjarjeje shumë serioze dhe ne do të kërkojmë të dimë se si mund të ketë ndodhur kjo, brenda parlamentit gjerman”, tha ai në një intervistë me Corriere della Sera.

“Sidoqoftë, ua them këtë nacionalistëve vendas, konfirmohet edhe një herë se AfD është një parti anti-italiane, armiku më i keq i vendit tonë”, shtoi kreu i diplomacisë italiane.

Siç nënvizon shtypi italian, referenca e Tajanit është për një konferencë që do të organizohet nesër nga Alternativa për Gjermaninë në zyrat e Bundestagut, parlamentit të vendit, me rastin e 80-vjetorit të nënshkrimit të marrëveshjes italo-austriake për Tirolin e Jugut. Ky është një rajon që i përket Italisë si rajon autonom dhe quhet Alto Adige në italisht.

“Posteri i konferencës ishte i qartë: Tirol i Jugut shfaqet si një shtet i veçantë dhe i pavarur”, tha Antonio Tajani.

“Nuk ka një çështje të tillë, është diçka budallallëk. Në fund të fundit, po flasim për një rajon që i përkiste Austrisë dhe jo Gjermanisë”, komentoi, nga ana e tij, eurodeputeti i AfD-së, Mark Jongen.

Së fundmi, eurodeputetët e partisë italiane Forza Italia, udhëheqës i së cilës është Tajani, njoftuan se do t'i kërkojnë Komisionit Evropian të marrë një qëndrim për këtë çështje specifike.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Aktori francez i jep fund jetës me eutanazi në Belgjikë, donte t'i jepte fund dhimbjeve shëndetësore - Euronews Albania](#)

22:40 Bota / 1 koment

Planifikonin të sulmonin komunitetin hebre, arrestohen dy persona në Britani


22:30 Bota

[Trump e zbulon: Zyrtarët amerikanë dhe iranianë zhvilluan takim tre orësh në OKB, "do të ketë marrëveshje"](#)

21:51 Bota

[Marrëveshje e re SHBA-Danimarkë-Groenlandë, Trump: Do ndërtojmë dy baza të mëdha ushtarake](#)

21:30 Bota / 4 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.